

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

|         |                                                                                                                                                                                                                                                                                     |
|---------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| TITULLI | Vllaznia shpërthen pas barazimit në Elbasan: Arbitrimi cenoi garën, të hetohen episodet vendimtare - EE TIMESTV.COM                                                                                                                                                                 |
| ADRESA  | <a href="https://eetimestv.com/2026/08/29/vllaznia-shperthen-pas-barazimit-ne-elbasan-arbitrimi-cenoi-garen-te-hetohen-episodet-vendimtare/">https://eetimestv.com/2026/08/29/vllaznia-shperthen-pas-barazimit-ne-elbasan-arbitrimi-cenoi-garen-te-hetohen-episodet-vendimtare/</a> |
| BURIMI  | eetimestv.com                                                                                                                                                                                                                                                                       |
| GJENDJA | online                                                                                                                                                                                                                                                                              |

## KOHA


|                       |                                                                                                                                                         |
|-----------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KAPUR NGA NE          | 6 shtator 2026, 14:42:37 UTC<br><i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>                           |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 29 gusht 2026, 21:10:01 UTC<br><i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i> |

## HASH-ET · SHA-256

|            |                                                                  |
|------------|------------------------------------------------------------------|
| PËRMBAJTJA | 802f3ab290146fb715264597818e1bda93ea854e2ee981076f1c9d7d2c506e56 |
| TEKSTI     | c745894b95b2923807a6197708e89572bcf889d907c3696d3d9b8cd605dd0296 |
| PAMJA      | 754a84137f9d24ea5323511a79f9f06c05b86e0e3642eb42951c400739163743 |

## ZINXHIRI I PROVËS

|               |                                                                    |
|---------------|--------------------------------------------------------------------|
| KJO HYRJE     | e23d9af80a6ad6689c5a336fd421e2ff8499bab8fad17d1fc43f7ac11f908bb1   |
| E MËPARSHMJA  | —                                                                  |
| RRËNJA MERKLE | bb4e79b3ec69077edf87697d0c7be1f8024ce2653cdf443ef98b2b2b16c0a234   |
| ANKORUAR      | Polygon PoS · bllok 47169057                                       |
| TRANSAKSIONI  | 0xc53d1d83eb5113e27101883e7ec1c599aedef807da486e98a6185fca192c6367 |
| IPFS          | QmVM2yPqkGdMM4oCMYr6dnZ3RqmeCHegWHRJZJGnzkgCiv                     |



## SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/e23d9af80a6ad6689c5a336fd421e2ff8499bab8fad17d1fc43f7ac11f908bb1>

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



SEPTEMBER 4, 2026

TITUJT KRYESORE:

Mbledhja me grupin parlamentar/ "Po qesh?" Rama i kthehet socialistit: Kanë ardhur kohë të këqija. Kush mendon që do e shtyjë sa ta shtyjë...

Shkoder, Albania

**eTIMES**  
Are you hungry for the truth? Or desperate to hide it?



Aktualitet

Kronike

Politike

Sport

E-Biz

Kulture

Sociale

Intervista

Bota

MUNDESI PUNESIMI



## Vllaznia shpërthen pas barazimit në Elbasan: Arbitrimi cenoi garën, të hetohen episodet vendimtare



eetimes • Aktualitet August 29, 2026 • 0 Comments




# DEKLARATË

Publicitet

**ama**  
Il mio amato caffè

AUTO VISI – MAKINA ME QERA



DEKLARATË PËR SHTYP

Klubi i Futbollit Vllaznia, pas përfundimit të ndeshjes AF Elbasani – KF Vllaznia, zhvilluar sot në stadiumin "Elbasan Arena" dhe përfunduar me rezultatin 1–1, e konsideron të domosdoshme të bëjë publik shqetësimin e tij për disa episode dhe rrethana që ndikuan negativisht në klimën sportive dhe mbarëvajtjen e kësaj ndeshjeje.

Së pari, pavarësisht se ndeshja, në zbatim të vendimit të organeve disiplinore, duhej të zhvillohej pa praninë e spektatorëve, në tribunën VIP ishin të pranishëm persona të cilët, gjatë gjithë ndeshjes, fyen dhe provokuan vazhdimisht lojtarët dhe përfaqësuesit e KF Vllaznia.

Përballë kësaj situatë, Klubi ynë konstatoi mungesën e reagimit të nevojshëm nga personat përgjegjës për organizimin, mbarëvajtjen dhe sigurinë e ndeshjes. Një situatë e tillë është e papranueshme, veçanërisht në një takim që, sipas vendimit disiplinor, duhej të zhvillohej pa publik.

Së dyti, po aq shqetësues për KF Vllaznia është edhe standardi i arbitrit të ndeshjes.

Në mënyrë të veçantë kërkojmë që të analizohet me seriozitet episodi i minutës së 34-t, kur, në momentin që Vllaznia kryesonte 1–0, lojtari i Elbasanit Abas kreu një ndërhyrje jashtëzakonisht të rëndë ndaj futbollistit tonë Mehmetaj.

Sipas vlerësimit të Klubit, ndërhyrja rrezikoi seriozisht shëndetin dhe karrierën e lojtarit tonë dhe, minimalisht, meritonte një shqyrtim të plotë përmes sistemit VAR. Mungesa e një reagimi proporcional ndaj një episodi të tillë ndikoi drejtpërdrejt në tensionin e krijuar në fushën e lojës dhe cenoi besimin e lojtarëve dhe stafit tonë ndaj standardit të arbitrit.

Në këtë kontekst, edhe dy golat e anuluar të KF Vllaznia në minutat shtesë, përkatësisht në 90+2 dhe 90+6, e bëjnë edhe më të domosdoshme që të gjitha episodet vendimtare të kësaj ndeshjeje të shqyrtohen me profesionalizëm dhe transparencë të plotë nga strukturat përgjegjëse të arbitrit.

KF Vllaznia nuk kërkon privilegje dhe nuk kërkon favorizim.

Kërkojmë vetëm atë që duhet t'i garantohet çdo klubi dhe çdo skuadër që hyn në fushën e lojës: gjykim të drejtë, standard të njëjtë për të gjithë, respektim rigoroz të rregullave dhe kushte që mbrojnë integritetin e garës.

Ne besojmë se episode të tilla, nëse nuk analizohen dhe adresohen me përgjegjësi nga institucionet përkatëse, dëmtojnë besimin te gara, cenojnë frymën e fair-play-t dhe krijojnë tensione që nuk i shërbejnë futbollit shqiptar.

KF Vllaznia do të vazhdojë të mbrojë me vendosmëri investimin, punën dhe interesat e Klubit, duke kërkuar me forcë respektimin e të drejtave tona vetëm në rrugë institucionale.

Në të njëjtën kohë, Klubi distancohet qartësisht nga çdo formë dhune, fyerjeje apo reagimi që bie ndesh me vlerat e sportit dhe u bën thirrje të gjithë aktorëve të futbollit të kontribuojnë për një garë të drejtë, të respektueshme dhe të denjë.

KF VLLAZNIA



eetimes

Krijuar për te dëshmuar!

Fund dramatik me dy gola të anuluar në Elbasani-Vllaznia

Benet Beci mbledh administratorët e pesë rajoneve: Zgjidhje të shpejta për shqetësimet e qytetarëve

Related Posts



eetimes • September 3, 2026 • 0 Comments

**Mbledhja me grupin parlamentar/ “Po qesh?” Rama i kthehet socialistit: Kanë ardhur kohë të këqija. Kush mendon që do e shtyjë sa ta shtyjë...**

Kryeministri Edi Rama ka reaguar me tone të ashpra gjatë fjalimit të tij, pasi vuri re se një prej socialistëve në sallë po qeshte. “Po qesh dikush aty? Kanë ardhur...

Lexoni me Shume



eetimes • September 2, 2026 • 0 Comments

## “Nuk na trembni me arrestime” – Aktivistja Luçiana Kokaj: Prangat duhet t’ua vendosni atyre që janë në qeveri

Aktivistja Luçiana Kokaj në protestën e 95 kundër qeverisë, bëri thirrje për lirimin e protestuesve të shoqëruar nga policia gjatë protestës së mbajtur një ditë më parë te Kryeministria e...

Lexoni me Shume

Other Story

AKTUALITET

**Mbledhja me grupin parlamentar/ “Po qesh?” Rama i kthehet socialistit: Kanë ardhur kohë të këqija. Kush mendon që do e shtyjë sa ta shtyjë...**

eetimes • September 3, 2026

AKTUALITET

**“Nuk na trembni me arrestime” – Aktivistja Luçiana Kokaj: Prangat duhet t’ua vendosni atyre që janë në qeveri**

eetimes • September 2, 2026

AKTUALITET

**Rama mbledh ministrat dhe drejtuesit politikë të qarqeve! Nesër takimi me Grupin e PS, 24 orët vendimtare për qeverinë**

eetimes • September 2, 2026

AKTUALITET

SPORT


**Pesha ndryshon, klasi mbetet, Qerimaj vendos 5 rekorde të reja kombëtare në Taranto 2026**

eetimes • September 2, 2026

AKTUALITET

Tragjedia me dy viktimë në Vaun e Dejës/ QKUM sqaron dinamikën e ngjarjes: Ambulanca e zonës ishte me defekt, urgjenca e Shkodrës mbërriti pas një ore e gjysmë

eetimes • September 1, 2026



AKTUALITET

Beci: Vijn aksioni për largimin e automjeteve të braktisura nga hapësirat publike

eetimes • September 1, 2026



[About Us](#)

[Terms of Service](#)

[Privacy Policy](#)

Copyright © 2026 EETIMESTV.COM | Powered by

[Desert Themes](#)



[Back to Top](#)

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.